



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 674/5 Prot.

Tiranë, më 05.07.2023

V E N D I M

Nr. 120, Datë 05.07.2023

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 104, datë 31.05.2023, e bërë nga F.Gj kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë (DVP Tiranë), në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Ka filluar marrëdhëniet e punës pranë DVP Tiranë, në datën 25.03.2016, sipas Urdhrit nr. 5530, datë 25.03.2016 të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, DVP Tiranë, me urdhërim për pranimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi të shërbimeve mbështetëse ka urdhëruar: F.Gj, e datëlindjes 05.10.1992, me arsim të lartë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë, Bachelor, në degën Fizioterapi, të pranohet dhe të emërohet përkohësisht në detyrën, Operator në Zyrën për Shërbimin ndaj Qytetarëve, në seksionin e Policimit në Komunitet, në Komisariatin e Policisë Kavajë, në DVP Tiranë. Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë është filluar procedimi penal në ngarkim të shtetases F.Gj e dyshuar për kryerjen e veprës penale të

¹ Për shkak të procedimit penal.

“Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Me Vendimin nr. 12-2019-1964/183, datë 26.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është vendosur:

- 1. Pranimi i kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.*
- 2. Të caktohet ndaj personit nën hetim F.Gj masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237, i Kodit të Procedurës Penale, dyshuar për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 248 dhe 245/1 të Kodit Penal.*
- 3. Personi nën hetim F.Gj urdhërohet të qëndrojë në banesën e saj në Kavajë.*

Si pasojë e këtij procedimi penal ankueses i është njoftuar Vendimi nr. 466, datë 04.11.2019 “Për pezullimin disiplinor nga detyra”.

Pas përfundimit të hetimeve, kjo çështje penale ka shkuar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me Vendimin nr. 12-2020-1936 (160), datë 29.12.2020 ka vendosur:

- 1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës F.Gj për akuzën e “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, pasi është larguar nga detyra për shkak të një procedimi penal, për të cilën është e pafajshme.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirisë dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga subjekti ankues informacion dhe dokumentacion plotësues, lidhur me përfundimin e hetimit disiplinor dhe marrëdhëniet të punësimit, pranë DVP Tiranë.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 01.06.2023 dhe me shkresën nr. 674/2, datë 05.06.2023, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues që të paraqesë informacion dhe dokumentacion si më poshtë:
 - Raportin përfundimtar të hetimit disiplinor të filluar me shkresën nr. 2470, datë 29.10.2019.
 - Vendimin për dhënie mase disiplinore, bazuar në raportin përfundimtar.
 - Ankimin në Komisionin Qendror të Apelimit. Nëse ka.
 - Vendimin e Komisionit të Apelimit. Nëse ka.
 - Informacion nëse marrëdhëniet e punësimit janë kundërshtuar në gjykatë. Nëse po, kopje të Kërkesë Padisë, kundërshtimit të palës tjetër apo vendimit të gjykatës. Nëse ka.
 - Kopje të librezës së punës.

Subjekti ankues, me shkresën protokolluar me tonën me nr. 674/3, datë 07.06.2023, dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së dhe parashtrimeve të saj, Komisioneri konstaton se:

- Me Vendimin nr. 466, datë 04.11.2019 *“Për pezullimin disiplinor nga detyra”*. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) ka vendosur: *“1. Punonjësja civile F.Gj të pezullohet disiplinarisht nga detyra. – Pezullimi të zgjasë deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor sipas përcaktimeve të nenit 222, pika 3, germa “ç” dhe pika 6 të Rregullores së Policisë së Shtetit”*.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me Vendimin nr. 12-2020-1936 (160), datë 29.12.2020 ka vendosur: - Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës F.Gj për akuzën e “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale”.
- DPPSH me Vendimin nr. 133, datë 18.02.2021 “Për ndërprerjen e pezullimit disiplinor nga detyra të një punonjësi policie”, vendosi: “Punonjësja civile F.Gj, ti ndërpritet pezullimi disiplinor nga detyra dhe të drejtat financiare dhe administrative ti rifillojnë në datën e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”.
- DVP Tiranë me Urdhrin nr. 1395/2, datë 25.02.2021 “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi administrativ”, urdhëroi: “F.Gj, me detyrë, Operator shërbimi për qytetarët në ZSHQ, në seksionin e Policimit në Komunitet, në Komisariatit e Policisë Kavajë, në DVP Tiranë, i ndërpritet pezullimi disiplinor nga detyra, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrën, Operator shërbimi 129, në Sektorin e Sallës së Komandimit, në DVP Tiranë”.
- DVP Tiranë me Urdhrin nr. 4512, datë 28.05.2021 “Për lirimin nga strukturat mbështetëse të policisë së shtetit të F.Gj”, urdhëroi: “F.Gj, me detyrë, Operator shërbimi 129, në Sektorin e Sallës së Komandimit, në DVP Tiranë, të lirohet nga strukturat e shërbimeve mbështetëse të Policisë së Shtetit, me motivacionin “Me kërkesën e saj””.

Në vlerësim të dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se ankuesja është larguar nga detyra me kërkesën e saj dhe jo si vendimmarrje e punëdhënësit për shkak të procedimit penal ndaj saj.

- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesja ka marrë dijëni për pezullimin nga detyra në datë 04.11.2019 dhe për lirimin nga detyra me kërkesë të saj, në datë 28.05.2021. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datë 31.05.2023**, pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetases F.Gj, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

² Për analogji shih vendimet nr. 209, datë 30.11.2022, nr. 211, datë 05.12.2022 dhe nr. 64, datë 27.04.2023 të Komisionerit.

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj³, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 104, datë 31.05.2023, të paraqitur nga F.Gj kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar: “Procedura para gjykatës”.